

**DEKLARATË E ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUES SPECIAL I
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-UT
DEBATI I KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR UNMIK-UN**

Nju Jork

14 nëntor 2017

Z. President, shkëlqesitë e juaja,

Më lejoni që fillimisht t'ju uroj ju, z. President, dhe shtetit tuaj Italisë për kryesimin e Këshillit gjatë këtij muaji, si dhe të shpreh kënaqësinë për pjesëmarrjen time në këtë mbledhje sot.

Periodha e fundit raportuese është mirë e mbuluar në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, të cilin po e shqyrtojmë sot. Unë do ta jap një raport shtesë lidhur me zhvillimet e fundit të rëndësishme që kanë ndodhur që nga përfundimi i periudhës raportuese.

Më 19 tetor u mbajtën zgjedhjet komunale në mbarë Kosovën, që ishin zgjedhjet e dyta lokale nga marrëveshja e parimeve e datës 19 prill 2013 mes Beogradit dhe Prishtinës. Rrjedhimisht, ishte hera e dytë që katër komunat me popullsi shumicë serbe të veriut të Kosovës morën pjesë në këto zgjedhje. Dalja në këto zgjedhje ishte e madhe, posaçërisht në zonat e populluara me shumicë serbe në tërë Kosovën. Përmes këtyre zgjedhjeve popullatës së Kosovës iu mundësua që të zgjedhin udhëheqësit e tyre më të afërt lokalë dhe kështu të shprehin pikëpamjet e tyre për prioritetet politike, si dhe për punën dhe realizimin e premtimeve të partive kryesore konkurruese. Mbi 7000 kandidatë nga krejt Kosova morën pjesë në to. Një rritje domethënëse e pjesëmarrjes së serbëve u pa në komunat me

shumicë serbe; dalja mesatare në zgjedhje ishte 43.4% në këto komuna krahasuar me 38%, sa ishte në vitin 2013. Në katër komunat e veriut dallimi ishte edhe më i theksuar: 44% krahasuar me 24%, sa dolën në vitin 2013. Ditën e zgjedhjeve Bashkimi Evropian dërgoi rreth 100 vëzhgues në tërë Kosovën, ndërsa OSBE-ja ndihmoi procesin e votimit në komunat e veriut. Të dy organizatat lavdëruan mbajtjen e zgjedhjeve që në përgjithësi ishin të qeta dhe të rregullta, megjithatë, vëzhguesit e BE-së gjithashtu theksuan se në komunat me shumicë serbe fushata u ndikua nga konkurrenca e kufizuar dhe ngacmimet.

Siç kam raportuar në gusht, proceset e shumta zgjedhore të këtij viti në Kosovë kanë rezultuar me një periudhë ku vendimet e marra nga autoritetet e duhura në Prishtinë kanë qenë të pakta. Pas zgjedhjeve të balotazhit të parapara më 19 nëntor dhe tani para përfundimit të proceseve zgjedhore, kam shpresa se kjo së shpejti do të ndryshon. Disa sinjale deri në një masë duken të jenë premtuese. Kuvendi i ri i Kosovës më 31 tetor miratoi leximin e dytë të buxhetit të Kosovës, përkundër shumicës së ngushtë të qeverisë. Deputetët serbë dhe kabineti i Kryeministrit bashkëpunuan në arritjen e këtij rezultati. Po ashtu, po shohim edhe sinjale të lëvizjes lidhur me çështjet e tjera të rëndësisë së veçantë, siç janë ato ekonomike dhe sociale, të cilat vazhdimisht janë zhagitur gjatë periudhës së zgjatur të zgjedhjeve.

Kjo ngritë pyetjen se çka na pret përpara. Gjatë tre muajve të kaluar kam pasur mundësinë e këmbimit të pikëpamjeve për gjendjen me palë të ndryshme në Prishtinë, Beograd dhe më gjerë. Së këndejmi, dëshiroj të theksoj faktin se të gjitha palët në përgjithësi kanë mendim të njëjtë se marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës kanë potencial të ndryshimit dhe të kalimit përtej qorrsokakut të gjatë dhe fatkeq.

Z. President,

Më 24 tetor, 40 gjyqtarë të ri dhe 13 prokurorë të ri të shtetit nga komuniteti serb kanë dhënë betimin në Kosovë që paraqet hap të rëndësishëm në zbatimin e marrëveshjes së parë të përkrahur nga BE-ja. Këta zyrtarë gjyqësorë do të punojnë në kuadër të sistemit të njësuar të drejtësisë në Kosovë. Punët lidhur me personelin dhe ato logjistike janë gjithashtu në zhvillim e sipër me përkrahjen e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, duke përfshirë edhe atë të UNMIK-ut. Palët duhet të përgëzohen për këtë përparim sepse gjyqësori ka pasur ngecje të dukshme krahasuar me të arriturat e tjera në procesin e zbatimit, siç është integrimi i policisë dhe realizimi i hapave teknikë në sferën e telekomunikimeve dhe në atë të shërbimeve publike.

Megjithatë, është gjithashtu me rëndësi të nënvizohet se thënë në përgjithësi, zbatimi i marrëveshjeve të arritura në vitin 2013 dhe më herët në rastin më të mirë vazhdon të jetë sporadik dhe i ndryshueshëm. Në kuadër të dialogut të përkrahur nga BE-ja, zbatimi teknik ka nevojë për një përkushtim më domethënës të të dyja palëve. Mangësia më e dukshme ende mbetet mungesa e përparimit në zbatimin e marrëveshjes së dakorduar për themelimin e bashkësisë/asociacionit të komunave serbe.

Z. President,

Një përparim i konsiderueshëm tanimë është bërë, dhe dialogu i përkrahur nga BE-ja mbetet thelbësor si element bazë i një procesi më të gjerë. Së bashku me këtë proces, Procesi i Berlinit i Bashkimit Evropian, përmes të cilit trajtohet potenciali i

zgjërimit në të ardhmen, gjithashtu ka shënuar avancime. Konferenca e shteteve të Ballkanit Perëndimor që ka filluar në vitin 2014 është pasuar me takime të mbajtura në vitin 2015 në Vjenë, në vitin 2016 në Paris dhe në vitin 2017 në Trieshtë. Përparësia e tij konsiston në përfundimin e pashmangshëm se zhvillimi ekonomik, paqja dhe prosperiteti varen nga cilësia e marrëdhënieve mes fqinjëve, nga krijimi i hapësirës së dobishme të ndërlidhshmërisë dhe nga perspektiva e ndërveprimit të shumanshëm. Pas diskutimeve të mia me udhëheqësit në Beograd, Prishtinë dhe Tiranë jam bindur se secila nga këto qendra të rëndësishme e kuptojnë këtë parim nga ky aspekt.

Përkitazi me dialogun politik mes Beogradit dhe Prishtinës, i cili ka kaluar nëpër një pauzë të gjatë, ajo që mund të them sot është se të dyja palët janë në dijeni për rëndësinë dhe potencialin e tij gjatë vitit që po vjen. Në dritën e kësaj, gjatë disa muajve të kaluar janë organizuar edhe konsultimet joformale me lehtësuesit e Bashkimit Evropian, ku më të rëndësishmet kanë qenë ato me Përfaqësuesen e lartë për punë të jashtme dhe politika të sigurisë, Federica Mogherini.

Dëshmitë për vullnet politik dhe zotim për të ecur përpara janë gjithnjë e më evidente. Populli me arsye është frustruar nga mungesa e mundësive si pasojë e mosbesimit politik të pazgjidhur dhe tensioneve. Me përfundimin e raundit të zgjedhjeve, tani është koha për veprim dhe jo për justifikime. Në shumë fusha praktike, grindjet politike dhe mosimplementimi i plotë i marrëveshjeve teknike vejnë një barrë të papranueshme mbi popullatën. Për shembull, pengesat e tepërta administrative vazhdojnë të dekurajojnë udhëtimin dhe tregtinë, përkundër marrëveshjeve që për qëllim kishin heqjen e pengesave të tilla.

Më lejoni të paraqes edhe një shembull, që u shfaq mu para disa ditësh. Në pajtim me mandatin e tij, UNMIK-u ka vazhduar të bëjë çdo gjë në kuadër të kompetencave të dhëna për të mbështetur implementimin e Marrëveshje së Lirë Tregtare në Evropën Qendrore, të cilën UNMIK-u e nënshkroi në emër të Kosovës në vitin 2006. Në praktikë, përfaqësuesit e Prishtinës të cilët punojnë për çështjet e CEFTA-s marrin pjesë në të gjitha takimet e CEFTA-s. Pjesëmarrja minimale e UNMIK-ut ka qenë gjithmonë në pajtim me masat e ligjshme. Përkundër këtyre fakteve, disa palë kohëve të fundit kërkuan t'i ripolitizojnë – përmes retorikës publike – këto marrëveshje, të cilat përndryshe janë shumë praktike, funksionale dhe të dobishme. Më lejoni, në këtë forum, të jem shumë i qartë: pjesëmarrja e UNMIK-ut vazhdon në mënyrë strikte deri në atë shkallë sa kërkohet nga anëtarët e CEFTA-s për të siguruar funksionalitetin e saj, që rrjedhimisht mbështet mundësitë ekonomike në mbarë rajonin. UNMIK-u njëjloj do të mbështesë çdo marrëveshje të arritur nga anëtarët e CEFTA-s, që atyre do t'ju mundësonte të punojnë në mënyrë të efektshme së bashku. Sipas këndvështrimit tonë, marrëveshjet e tilla më së miri arrihen përmes diskutimeve mes palëve të interesuara dhe jo përmes mediave.

Z. President,

Unë më herët e kam theksuar këtu dhe e kam përgëzuar iniciativën e Presidentit Vuçiq, për dialog të brendshëm mbi pozicionin e Serbisë për çështjen e Kosovës. Unë po ashtu kam cekur se Kryeministri Edi Rama në Tiranë ka theksuar se vlerësimet e tilla të brendshme nuk do të mbesin pa u realizuar as në Tiranë dhe as në Prishtinë. Këto pozicione me mendime pozitive i shërbejnë në fakt popullit, meqë kërkojnë t'i trajtojnë faktet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Liderët në Bashkimin Evropian, pavarësisht nga sfidat e mëdha globale të shumëllojshme, me të cilat ata përballen, angazhimin e përqendruar në rajon e kanë vendosur si prioritet. Të gjitha

palët tani po ashtu duhet ta luajnë rolin e tyre. Kjo është teza mbi të cilën qëndron dialogu në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Është me rëndësi që potenciali për fillimin e një procesi të qëndrueshëm të paqes të mos pengohet me mosfleksibilitet apo thjeshtë me mosveprim.

Z. President,

Derisa dialogu dhe iniciativat e tjera diplomatike mund të sigurojnë një bazë të re për krijimin e paqes, puna serioze për trajtimin e çështjeve urgjente po ashtu ka nevojë për një përqendrim dinamik në Prishtinë. Objektivat kryesore janë sigurimi më se i nevojshëm i mundësive ekonomike dhe i atyre të punësimit, nevoja për të ndalur korrupsionin publik dhe sigurimi i përgjegjshmërisë publike në të gjitha nivelet, dhe ndoshta mbi të gjitha, luftimi i krimit të organizuar.

Z. President,

Misioni ynë në Kosovë është duke punuar veçanërisht në nivelet lokale në përkrahjen e njerëzve që të përfitojnë nga bashkëpunimi dhe pajtimi. Ne i përdorim fondet në dispozicion për të mbështetur iniciativat e nivelit lokal, të cilat formësojnë të ardhmen dhe perspektivën për gjeneratën e pasluftës në Kosovë. Talenti nuk njihet kufi të gjinisë, të prejardhjes etnike ose të përkatësisë politike.

Ne shohim energji brenda kësaj qeverie të re, e cila po ndërmerr hapa të ri për të punuar në një partneritet shumetnik. Këtë energji e shohim po ashtu në iniciativat mbarërajonale për të larguar murtajën e ndikimeve politike në vendosjen e drejtësisë dhe sundimit të ligjit, por edhe në iniciativat e guximshme të cilat ndërmerren nga

të gjithë, për të shqyrtuar në mënyrë fundamentale çështjet që Ballkanit Perëndimorë do t'ia mundësojnë vazhdimin e avancimit të aspiratave evropiane.

Vëmendja jonë është fokusuar po ashtu në çështjet, të cilat kërkojnë më shumë përqendrim dhe që janë esenciale për pajtimin dhe ndërtimin e besimit. Këto përfshijnë iniciativat për t'i përfshirë gratë në proceset politike; ndihmën për t'u kushtuar vëmendje historive të patreguara të atyre që kanë qenë në shënjestër gjatë kohës së konfliktit; avancimin e rolit të rinisë në paqen dhe sigurinë dhe punën më e madhe në zgjidhjen e rasteve të shumë personave ende të zhdukur nga lufta. Ne kemi partneritet të hapur me të gjitha qeveritë për trajtimin e këtyre çështjeve. Po ashtu, ne jemi të vetëdijshëm për sfidat e mëdha në sigurimin e lirisë së identitetit kulturor dhe religjioz, dhe në luftën kundër qëndrimeve ekstreme dhe mendjengushta, të cilat aktualisht janë kërcënim dhe shqetësim jo vetëm në rajonin tonë, por në mbarë botën.

Z. President,

UNMIK-u vazhdon ta luajë rolin e tij duke punuar në drejtim të një partneriteti më të ngushtë me të gjitha pranitë ndërkombëtare në vend dhe me të gjithë palët e angazhuara, veçanërisht në një kohë kur ne jemi dëshmitarë të dinamikave të reja që po shfaqen në rajon. Qëllimi përfundimtar i Misionit, me përkrahjen tuaj, mbetet i qartë - paqe e qëndrueshme dhe mundësitë që ajo ua sjell individëve në përmbushjen e aspiratave dhe potencialit të tyre.

Ju faleminderit z. President.

CHECK AGAINST DELIVERY